



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 43/09

Prishtinë, më 2.02.2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Myrvete Pantina, Shkumbin Demaliaj, Müfera Şinik, Xhevdet Neziraj, Riza Smaka, Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani.

Anëtarët jo të pranishëm: Besa Gaxherri, Hajdin Abazi.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Dino Hasanaj, Shkumbin Bicaj, Avni Jashari nga AKP, Adrian Zalli, Vërshim Tahipi nga TKPK, Teki Shala, Shefki Kastrati nga NDI, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 26 janar 2009**
- 3. Shqyrtimi i Raportit tre mujorë mbi aktivitetet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dt. 23.12.2008 me Përfundimin nr. 03-P-066/k dt. 13.01.2009 të Kryesisë së Kuvendit
Të ftuarit: Përfaqësuesit e Bordit të AKP-së**
- 4. Shytimi i Raportit nr. 03/1590/Do 947 dt. 21. 01 2009 të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për tremujorin e IV të vitit 2008
Të ftuarit: Përfaqësuesit e menagjmentit të TKPK –së**
- 5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit nr. 19/48/ dt. 24. 12 . 2008 të Qeverisë me Përfundim nr. 03–P- 063/k dt. 13.01.2009 e Kryesisë së Kuvendit për Strategjinë Kundër Korrupsionit për periudhën 2009-2011**

6. **Prezantimi i Draft – Planit të Punës së Komisionit për vitin 2009 ne pajtim me Strategjinë Legjislative të Qeverisë për vitin 2009**
7. **Të ndryshme.**

Kryesuesi, arsyetoi mungesën e znj. Besa Gaxherri dhe z. Hajdin Abazi. Më pas hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 26 janar 2009

Kryesuesi, konstatoi se procesverbalet nga mbledhja e kaluar dt. 19 janar 2009 miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit tre mujorë mbi aktivitetet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dt. 23.12.2008 me Përfundimin nr. 03-P-066/k dt. 13.01.2009 të Kryesisë së Kuvendit

Kryesuesi, theksoi se nga paraqitja e raportit shifet se është përgatitur mirë konform dispozitave ligjore. Duke pasur parasysh faktin se është hera e parë që shqyrtojmë raportin e këtij agjencion, ai përmbush kushtet për diskutim.

Dino Asanaj, theksoi se nga raporti shifet se brenda periudhës së caktuar, AKP-ja ka arritur disa rezultate, janë realizuar tri valë të privatizimit, janë shpërndarë mjetet e 20% të shtatë ndërmarrjeve.

Haki Shatri, mbështeti raportin dhe kërkoi që të vazhdohet me procesin e privatizimit në mënyrë sa më dinamike. Pyeti se a ka filluar punën Oda e Veçantë, funksionimi i së cilës ndikon në punën e AKP-së.

Naser Osmani, theksoi se në bazë të raportit, përveç konsolidimit të AKP-së, privatizimit të ndërmarrjeve, kthimi e 20% prej disa ndërmarrjeve, përshtypje e veçantë i ka bërë çështja e dokumentacionit të djegur. Pyeti se pas takimit që kanë pasur me përfaqësuesit e UNMIK-ut, a kanë marrë dokumentacionin e kërkuar në formën e elektronike, dhe a ka filluar ndonjë procedurë hetimore lidhur me rastin. Do të ishte mirë të jepet informacion se qfarë do të bëhet me ndërmarrjet e privatizuara që nuk kanë respektuar kontratat e shitblerjes. Z. Osmani u interesua për mjetet e plasuar jashtë vendit, pyeti se a janë të garantuara ato. Njëkohësisht kërkoi që këto mjete të mos plasoheshin për përfitime, për arsye se nuk jeni institucion financiar.

Myrvete Pantina, vlerësoi raporti përmbledhës, por megjithatë në raport do të duhej të përfshihej edhe analiza e punës së ndërmarrjeve që janë privatizuar më herët, duke treguar për gjendjen e tyre, për përmbushjen apo jo të kontratave. Pyeti pse nuk është bërë pranim dorëzimi zyrtar nga AKM-AKP.

Riza Smaka, vlerësoi raportin përmbajtësor me të dhëna të mjaftueshme. Por megjithatë ka pasur nevojë për plotësime. Do të ishte mirë të bëhej një vlerësim për mosfunksionimin e Odës së Veçantë. Po ashtu do të duhej të bëhej një analizë kritike për statusin e subjekteve biznesore të privatizuara më parë, të cilat nuk po iu përmbahen kontratave, si dhe ndërmarrja e masave për ato ndërmarrje që nuk i përfillin kontratat. Kërkoi që lidhur me dokumentacioni e djegur të bëhet çdo gjë që është e mundur për tu ndriçuar ato. Përndryshe mbështeti miratimin e raportin.

Kosara Nikolić, u pajtua me konstatimet për ndriçimin e dokumentacionit të djegur, personat përgjegjës të dalin para drejtësisë. Kërkoj që puna e Odës së Veçantë të filloj punën sa më shpejtë. Përndryshe përkrahu raportin.

Safete Hadërgjonaj, duke pasur parasysh kohën e shkurtër të veprimit të këtij agjencioni, vlerësoi të mirë përgatitjen e raportit. Në këtë drejtim vlerësoi edhe nxjerrjen e akteve nënligjore që kanë krijuar kornizën e punës së agjencionit. Lidhur me shpërndarjen e listës së 20%, pyeti pse ka pasur neglizhenca, a ka shumë punëtor që nuk kanë marrë këtë shumë, ku qëndron problemi i zvarritjeve.

Shkumbin Demaliaj, lidhur me dokumentet e djegura, pyeti se a kanë gjetur diçka. Po ashtu u pajtua me vërejtjet për ndërmarrjet e privatizuara, kërkoj që të rishikohet çështja e respektimit të kontratave, në veçanti me Hotelin Grand. Njëkohësisht u interesua për pengesat në funksionimin e Odës së Veçantë, funksionimin i së cilës do të zgjidhte shumë probleme që janë shfaqur me pronat me rastin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Shkumbin Bicaj, theksoi se funksionimi i Odës së Veçantë është edhe në interesin e tyre për të përshpejtuar dinamizmin e punëve. Mosfunksionimi i saj ka sjellur vonesa në shpërndarjen e 20%, ka ndodhur që një ankesë ka marrë kohë dy vjet deri në nxjerrjen e vendimit final. Megjithë vendimet finale, ka pasur raste kur Oda ka reviduar vendimet tri herë. Në përgjigjen e z. Demaliaj, për problemet pronësore të ndërmarrjeve shoqërore, theksoi në këtë drejtim pengesë ka paraqitur mungesa e ligjit për kompensimet. Pas transformimit, agjencioni është duke analizuar ndërmarrjet para privatizimit të tyre me qëllim të definimit të pronës shoqërore. Në rast se Gjykata konteston pronën e ndërmarrjes, ne e heqim nga procesi i privatizimit.

Kryesuesi, theksoi se në këtë periudhë AKP-ja është përqendruar në sukseset e saja, ndërsa kërkoj që në raportin vjetor të përfshihen edhe pjesët që konsiderohen pengesë për punën e AKP-së. Pyeti se mjetet e depozituara në BQK a janë të siguruara.

Dino Asanaj, duke iu përgjigjur pyetjeve, theksoi se arsyeja e mos pranimit-dorëzimit zyrtar nga AKM-AKP ka qenë problem teknik, i cili më vonë është shëndrruar në problem politik dhe ka mundësi të shëndrrohet edhe në problem kriminal. Lidhur me dokumentacionin e djegur, pas kërkesës së tyre kanë pranuar në formë elektronike letrat e ish-bordit, ndërsa kompjuterët i kanë pranuar të zbrazët. Deri më tani nuk jemi në gjendje të konstatojmë gjendjen e tyre për shkak se është punë e vëllimshme. Tani është rritur numri i stafit që do të punojmë në këtë drejtim. Në pyetjen për mosrespektimin e kontratave nga ndërmarrjet e privatizuara me spin of special, theksoi se disa prej tyre i kanë tejkaluar investimet (Feronikeli, Birraria Peja, Sillosi), ndërsa disa tjera kanë ngecur në përmbushjen e obligimeve, ndër të cilat prin Hoteli Grand. Sa i përket ndërmarrjes “Llamkos” kemi kërkuar të bëhet auditimi i jashtëm profesional. Sa i përket deponimit të mjeteve të privatizimit në BQK, në takimet që kemi pasur me përfaqësuesit e BQK-së, kemi kërkuar që ato mjete të jenë të garantuara nga humbjet financiare dhe të kthehen në Kosovë. Përgjigjen e kemi marrë se ato janë të sigurta. Po ashtu kemi kërkuar të bëhet një marrëveshje për garantimin e këtyre mjeteve.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Komisioni miratoi në parim Raportin tremujor të Agjencionit Kosovar të Privatizimit.
- II. Komisioni konstatoi se raporti është në përputhje me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

- III. Komisioni konstatoi se ka të arritura në punën e Agjencionit Kosovar të Privatizimit në pjesën e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, dhe sidomos në përmbushjen e obligimeve për ndarjen e 20% që u takon punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuara.
- IV. Komisioni kërkoi nga Agjencioni që në raportin vjetor për vitin 2008 të përfshihet edhe pjesa e veçantë e raportimit lidhur me përmbushjen e kontratave të ndërmarrjeve të privatizuara me spin of special.

4. Shytimi i Raportit nr. 03/1590/Do 947 dt. 21. 01 2009 të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për tremujorin e IV të vitit 2008

Kryesuesi, duke pasur parasysh raportin se përmban vetëm shifra, dhe jo përshkrime me fjalë të tij, e vlerësoi të nevojshëm që përfaqësuesit e trustit të japin sqarime të mëtutjeshme.

Vërshim Hatipi, duke iu përgjigjur vërejtjeve për formatin e raportimit, theksoi se ky është një format i rekomanduar nga BQK-ja dhe se kanë informacione se po përgatitet një format unik për të gjitha agjencionet e pavarura financiare. Në vazhdim theksoi se në BQK janë 34 milion € si kontributet e reja të cilat nuk janë investuar në mungesë të bordit. Janë bërë afatizime në dy banka, në Raiffeisen Bank 10 milion € dhe në Procredit Bank 5 milion €. Ndërsa 75 milion janë investuar në bonat e thesarit, në tregun e parave të gatshme janë 4 milion €. Mjetet e investuara në aksione, kanë pasur një rënje të vlerës së tyre prej 112 milion €. Sa i përket humbjeve, gjatë tre mujorit të fundit janë humbur 41.8 milion €. Pjesa tjetër e raportit përmban kthimin e investimeve, pjesën e investimeve, tarifave administrative, pagesat e pensioneve, refundimet. Trusti përmbyll vitin 2008 me një rënje të vlerës së mjeteve mbi 91 milion €, në përqindje 29.5%. Ndërsa fondi aktualisht disponon asete prej 253,842,714.41 milion €.

Kryesuesi, pyeti se është norma e interesit për mjetet e deponuara në bankat e përmendura.

Vërshim Hatipi, duke iu përgjigjur parafolësit, theksoi se norma e interesit në Raiffeisen Bank është 5.6 %, ndërsa në Procredit Bank 5.1 %. Afatizimet janë bërë për dy vite.

Myrvete Pantina, theksoi se do të ishte mirë që në raport të bëhej edhe një analizë me shkrim rreth gjendjes së mjeteve pensionale. Gjithashtu një tabelë për të hyrat dhe të dalat e TKPK-së, pozicionin e pagave. Pyeti se a do të thotë se nga shuma totale prej 253 milion € janë zbritur humbjet prej 91 milion €.

Haki Shatri, duke pasur parasysh faktin se në bazë të ligjit, nëse kalohet shuma e caktuar për investime, guvernatori i BQK-së duhet ndërhyj, a ka ndërmarr ndonjë veprim të BQK-ja deri më tani. Pyeti se a po vazhdon trendi i humbjeve të mjeteve të trustit edhe këtë vit.

Riza Smaka, theksoi se raporti do të duhej të ishte më i përshkruar, të përfshiheshin pozicionet e pagave, pasqyra e të hyrave dhe dalurave. Prandaj kërkoi që të njëjtat të përfshiheshin në raportet e ardhshme. Gjithashtu theksoi se do të duhej të bëhej një analizë kontratave për mjetet e investuara jashtë vendit.

Safete Hadërgjonaj, duke pasur parasysh faktin se po humbin mjetet e trustit, pyeti përfaqësuesit e trustit, qfarë keni bërë si menaxhment në mungesë të bordit për të sensibilizuar organet kompetente për të ndërmarr masa për të parandaluar humbjet. Po të ndërmerreshin masa para katër muajsh, a do të mund të parandalonim humbjet që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe.

Adrian Zalli, duke iu përgjigjur z. Shatri, theksoi se ligji thotë se autoritet i vetëm për të marrë vendime për investimin e mjeteve është bordi. Guvernatori i BQK-së mund të ndërmarr veprime konkrete në marrëveshje reciproke me bordin. Në pyetjen se a do të mund të bënim diçka për të parandaluar humbjet nëse do të merreshin masat më herët, theksoi se do të ishte vështirë për shkak të krizës globale financiare. Ndërsa në pyetjen e humbjeve për këtë vit, theksoi se muaji janar ka qenë muaji më i keq sa i përket humbjeve. Dhe se situata po shkon duke u përkeqësuar dhe indikacionet janë se kriza do të vazhdoj deri në fund të vitit 2009. Sa i përket kontratave ato janë likuide, mund të ndërpriten por se në bazë të ligjit për to duhet vendos bordi.

Safete Hadërgjonaj, propozoi që Komisioni të kërkoj një takim me Guvernatorin e BQK-së për të pyetur për lëvizjet që ka bërë në këtë drejtim, ashtu siç e obligon ligji.

Naser Osmani, theksoi që në emër të Komisionit të kërkoj nga Qeveria të përshpejtoj procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të bordit, njëkohësisht të kërkoj dorëzimi dhe shqyrtimi i raportit vjetor të TKPK-së në Kuvend. Ndërsa lidhur me investimet e mjeteve në mungesë të bordit, theksoi se menaxhmenti është ai që duhet bërë analiza për investimin e mjeteve dhe të ofroj në formë të propozimeve bordit për aprovim.

Haki Shatri, theksoi se përkundër zbrastërave ligjore, në ligj nuk thuhet se guvernatori nuk mund të ndërmarr veprime në mungesë të bordit. Pasi që ai mund të kërkoj nga bordi të ndërmarr veprime urgjente për situatën e krijuar, interpretimi i dispozitës nënkupton se ai mund të veproj edhe në mungesë të bordit. Duke ditur mundësinë e ndërprerjes së kontratave për mjetet e investuar, dhe duke parë trendet negative në tregjet financiare, Komisioni të kërkoj nga Guvernatori të bëjë ndërprerjen e këtyre kontratave, në mënyrë që të shpëtohen ato mjete që kanë mbetur. Pyeti përfaqësuesit e menaxhmentit se a janë të sigurta shifrat e prezantuara në raport.

Ardian Zalli, duke iu përgjigjur parafolësit, theksoi se për çdo dyshim në shifrat e prezantuara në raport mund të shikohen raportet e auditorit të jashtëm.

Kryesuesi, theksoi se neni 34.3 i Rregullores së Fondit Pensional, respektivisht neni 6.3 (b) i Ligjit që e ndryshon atë përcakton qartë se kur Fondi shkon në humbje mbi 10%, Guvernatori duhet të reagoj menjëherë dhe të kërkoj me shkrim nga Qeveria dhe Kuvendi ndërmarrjeve e veprimeve të caktuara. Interpretimi i kësaj dispozite nënkupton se në rast mosfunksionimit të bordit, përgjegjësit kalojnë direkt tek guvernatori. Nga kjo që po ndodh me trustin, ndihet nevoja për reformimin e tij. Në këtë drejtim do të kërkoj ndryshimi i Ligjit të Tustit.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Miratohet në parim Raporti i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për tremujorin e IV-të të vitit 2008, dhe i rekomandon Kryesisë së Kuvendit që të njëjtin ta radhis në rend dite për shqyrtim në seancën plenare. Në mungesë të Bordit të TKPK-së, të ftohet Guvernatori i BQK-së për raportim në Kuvend.
- II. Obligohet Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës që të ndërmerr masa adekuate lidhur me administrimin dhe udhëheqjen e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, në përputhje me nenin 34.3 të Rregullores nr. 2005/20 dhe nenin 6.3. (b) të Ligjit mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/20, mbi Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

III. I rekomandohet Qeverisë së Republikës së Kosovës që të përshpejtoj procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit nr. 19/48/ dt. 24.12.2008 të Qeverisë me Përfundim nr.03-P-063/k dt. 13.01.2009 e Kryesisë së Kuvendit për Strategjinë Kundër Korrupsionit për periudhën 2009-2011

Riza Smaka, kërkoi disa korrigjime në tekstin e projekt-strategjisë kundër korrupsionit 2009-2011. Në fq. 6 dhe 8 përkufizimi i definicionit “korrupsion” është tepër i ngushtë dhe joadekuat, po ashtu kuptimi “shteti i së drejtës” nuk është mirë i definuar. Gjithashtu është përdorur shpesh fjala “do të”, e që duhej të jetë “është”.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Miratohet në parim Projekt-strategjia kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011 dhe i rekomandon Kryesisë së Kuvendit që të njëjtin ta radhis në rend dite për shqyrtim në seancën plenare.

6. Prezantimi i Draft – Planit të Punës së Komisionit për vitin 2009 ne pajtim me Strategjinë Legjislative të Qeverisë për vitin 2009

Kryesuesi, njoftoi se plani dhe programi i punës së Komisionit është hartuar konform strategjisë legjislative të Qeverisë për vitin 2009. I njëjti mund të jetë objekt diskutimi dhe plotësimi në varësisht prej aktiviteteve dhe nevojave të Komisionit.

Pas që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

VENDIM

- I. Miratohet Draft – Planit të Punës së Komisionit për vitin 2009 ne pajtim me Strategjinë Legjislative të Qeverisë për vitin 2009.

Mbledhja përfundoi në ora 13:40

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI